

CLE prezantohet pranë publikut - Ndhimja Ligjore, Shoqëria Civile, Komunitetet: Trinomi i rezistencës qytetare

Pas punës 4-vjeçare dhe suksesit të vazhdueshëm të projektit "Klinikat e Ligjit" lindi nevoja për garantimin e vazhdimësisë së këtij mekanizmi të suksesshëm me themelimin e Qendrës "Centre for Legal Empowerment - CLE" në dhjetor të 2021.

Në 3 shkurt, CLE erdhi pranë publikut me zhvillimin e tryezës së diskutimit "Ndhimja Ligjore, Shoqëria Civile, Komunitetet – Trinomi i rezistencës qytetare". Në këtë takim hibrid me pjesëmarrjen e përfaqësueses së Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, Znj. Chantal Nicod, Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Z. Andi Dobrush, Drejtorit të Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas Z. Ergys Qirici, Drejtorit Ekzekutiv të CLE Z. Franc Terihati, dhe me pjesëmarrjen e aktivistëve të shoqërisë civile, qytetarëve, avokatëve dhe gazetarëve, u diskutua mbi nismën e "Klinikave të Ligjit", mbështetjen e qytetarëve dhe komuniteteve në litigimin e kauzave të tyre, garantimin e aksesit në drejtësi dhe krijimin e precedentëve pozitivë në fushën e drejtësisë.



[Lexo më shumë >](#)

Raste Gjyqësore

Prishja e banesave të tre familjeve të komunitetit Rom

Gjykata i njehtë drejtën e dëmshpërblimit 3 familjeve të komunitetit rom shtëpitë e të cilave ishin prishur për t'i lënë vend ndërtimit të Unazës së Madhe të Tiranës.

Tre familje të komunitetit Rom, kishin ndërtuar banesat e tyre përpara vitit 1991 pranë segmentit rrugor Komuna e Parisit- Rruga e Kavajës. Në vitin 2016 në këtë segment rrugor do të nisnin punimet për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës. Shtëpitë e banimit të tre familjeve u prishën nga aksioni i IKMT-së në datat 18-19.02.2016 dhe familjet mbetën të pastreha duke u dëmtuar ekonomikisht, sepse humbën investimin e gjithë jetës, dhe duke pësuar një ngarkesë të madhe emocionale dhe psikologjike.

Në rastin e parë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin e datës 13.12.2016 pranoi padinë dhe njohu të drejtën e shpërblimit të dëmit nga Bashkia Tiranë dhe IKMT në shumën **5 822 000 Lekë**.

Në rastin e dytë, gjykata me vendimin e datës 22.09.2020 pranoi padinë dhe njohu të drejtën e shpërblimit të dëmit nga Bashkia Tiranë dhe IKMT në shumën **3 785 000 Lekë**.

Ne rastin e tretë gjykata nëpërmjet vendimit që u shpall ditën e mërkurë datë 14 Qershor 2022, pranoi padinë dhe njohu të drejtën e shpërblimit të dëmit nga Autoriteti Rrugor Shqiptar në shumën **5 596 555 Lekë**.



[Lexo më shumë >](#)

Kundërshtimi i HEC në parkun e Zall – Gjocaj

Anulohet vendimi për prodhimin e energjisë elektrike në hidrocentralin e Zall-Gjocaj.

Dy hidrocentrale (HEC) po ndërtohen në lumin Mat, në kundërshtim me legjislacionin mjedisor dhe aktet e tjera ligjore. Një pjesë e madhe e projektit po zhvillohet në Parkun Kombëtar "Lurë - Deja", i cili ishte i cilësuar si zonë e mbrojtur. Ky projekt u zhvillua pa u konsultuar me banorët e zonës, të cilët kërkuan ndihmë juridike nga avokatët e CLE për të mbrojtur këtë zonë.



[Lexo më shumë >](#)

Gjykata Administrative e Apelit vendosi të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila anuloi vendimin e ERE-s (Entiteti Rregullator i Energjisë) për licencimin e kompanisë për ndërtimin e një hidrocentrali me kapacitet 2295 KW në një zonë të mbrojtur. Më pas Gjykata e Lartë vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Më 24 nëntor 2022, Gjykata e Lartë vendosi lënien në fuqi të vendimeve të mëparshme, duke i hequr licencën kompanisë koncesionare të prodhimit të energjisë për Hec Zajs, në Zall Gjocaj.

Kundërshtimi i ndërtimit të thertoresh në pyllin e Laknasit

Plepat e Brukës mbeten një zonë natyrore e paprekur pas përpjekjeve të shumta të banorëve të cilat u finalizuan me sukses.

Gjykata Administrative e Tiranës vendosi se banorët e Laknasit kanë të drejtë në kauzën e tyre për mbrojtjen e "Pyllit të Brukës" kundrejt vendimeve për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike brenda tij. Rezistenca e banorëve të Laknasit, e mbështetur nga paralogorët e Qendra Kujri dhe ndihmës juridike të avokatëve të Centre for Legal Empowerment, bëri të mundur ruajtjen e "Pyllit të Brukës", të cilin banorët e zonës e kanë ndërtuar me vullnetin e tyre dhe nuk e kanë lejuar që prej 2019, prishjen e kësaj pasurie natyrore dhe ndërtimin mbi të.



[Lexo më shumë >](#)

Kundërshtohet ndërtimin i hidrocentraleve në Thirrë

166 banorë të fshatrave Thirrë, Sang dhe Xhuxh të Bashkisë Mirditë kanë kundërshtuar ndërtimin e hidrocentraleve në Thirrë

Dy HEC-e dhe një fabrikë uji janë planifikuar të ndërtohen në fshatrat Thirrë, Sang dhe Xhuxh të Bashkisë Mirditë. Duke qenë se këto projekte do të prekin rëndë jetën e të gjithë banorëve të zonës, ata i kanë kundërshtuar projektet përmes ankesave administrative dhe protestave masive. Avokatët e CLE kanë dërguar padinë në gjykatë ku përfaqësojnë 166 banorë të zonës.



[Lexo më shumë >](#)

Kundërshtohet ndërtimi i HEC-it në Madhesh të Burrelit

Vijon procesi Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për kundërshtimin e HEC në lumin Mat.

Disa organizata mjedisore referuan pranë CLE problematikën e ndërtimit të HEC në Madhesh të Burrelit.

Avokatët zhvilluan takime me banorët e 4 fshatrave të Matit (Madhesh, Gurrë, Lundër, Beshkashi), mblodhën dokumentacionin nëpërmjet paraqitjes së kërkesave për informacion pranë organeve publike, dhe adresuan rastin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku çështja është ende në shqyrtim.



[Lexo më shumë >](#)

Kërkesë për pagesën e punës së kryer në festat zyrtare

CLE po përfaqëson në Gjykatë punonjës të call center të cilët nuk kanë marrë pagesën e merituar për punën e kryer gjatë festave zyrtare

CLE përfaqëson në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë punonjës të sektorit call center dhe Sindikatës Kombëtare të Operatorëve të Telefonisë (SKOT) në gjykimin e një mosmarrëveshjeje me punëdhënësin për pagesën e punës së kryer në ditët e festave zyrtare pa pagesë deri në dhjetor 2018. Pasi u dorëzua në gjykatë kërkesëpapia e 190 punonjësve të cilëve iu është refuzuar pagesa për punën e kryer në ditë festash gjatë vitit 2018, SKOT është njoftuar se punëdhënësi ka vendosur t'u paguajë 190 punonjësve pagesën mesatare.

Punëdhënësi nuk ka paguar ende rreth 70 punonjës që aktualisht nuk janë të punësuar në këtë kompani. Si rezultat, ne po vazhdojmë të ndjekim procesin gjyqësor, i cili ka nisur në janar 2021.



[Lexo më shumë >](#)

Kërkesë për dëmshpërblim, si pasojë e pushimit kolektiv të padrejtë nga puna

12 punonjës padisin shoqërinë call centre për pushimin kolektiv nga puna në kundërshtim me afatet dhe procedurat e përcaktuara në ligj

CLE ka dërguar në gjykatë padinë e 12 punonjësve të cilët ishin pjesë e një grupi prej 188 punonjësve të cilët pretendojnë se janë pushuar padrejtësisht nga puna.

E njohur me këtë çështje, CLE, me kërkesën e 12 prej punonjësve tashmë të pushuar nga puna, mori përsipër ndjekjen ligjore të saj me hartimin e një padie kundër kompanisë call-centre dhe përfaqësimin e dikujt në gjykatë.

Kërkesat e paditësve bazohen në një vijimësi parregullsish nga shoqëria të cilat nisin që në momentin kur punonjësit njoftohen mbi pushimin kolektiv nga puna, dhe vijojnë me zhvillimin e seancave këshilluese në mungesë të Sindikatës Kombëtare të Operatorëve Telefonikë (SKOT) dhe shpalljen e tyre të mbyllura pa i dhënë përgjigje çështjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga punonjësit.

Paditësit pretendojnë në total 20,186,040 ALL dëmshpërblim për dëmet e shkaktuara nga pushimi kolektiv nga puna.

Padia tashmë është depozituar në gjykatë dhe pritet njoftimi në lidhje me zhvillimin e çështjes gjyqësore dhe zgjidhja e problematikës së adresuar nga punëmarrësit.

Aktivite dhe Projekte

Zbatimi i ndërmjetësimit në marrëdhëniet e punës

Për të rritur nivelin e informimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kontraktuale përmes ndërmjetësimit, CLE po zhvillon një fushatë me aktivitete në terren duke u ulur bashkarisht me bizneset, punëmarrës, punëdhënës, grupe interesi dhe dhomat e tregtisë.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në marrëdhëniet e punës konform ligjeve në fuqi dhe kushteve kontraktuale vijon të jetë një çështje apo sektor problematik dhe me shumë të panjohura, jo vetëm për punëmarrësit por edhe punëdhënësit. Centre for Legal Empowerment ka ndërmarrë nismën “Zbatimi i ndërmjetësimit në marrëdhëniet e punës në fushën e fasonerisë dhe call centër”. Në kuadër të kësaj nisme, deri më tani, është zhvilluar një takim me sipërmarrës të fushës së fasonerisë në Gjirokastrë, takim informues me grupet e interesit, si dhe është bërë publikimi i një [manuali praktik](#) informues mbi këtë temë.



[Lexo më shumë >](#)

Publikohet raporti studimor mbi ndërmjetësimin në marrëdhëniet e punës

CLE publikon raportin studimor *“Ndërmjetësimi, si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në punë, ende një “tabu” në realitetin shqiptar.”*

Raporti i përgatitur nga ekspertët ligjor Av. Msc. Arbësa Kurti, Av. Franc Terihati, Prof. Dr. Sokol Mëngjesi, dhe Av. Pirro Boboli, paraqet një pasqyrë e një tablo të përgjithshme të analizës ligjore të rregullimit të marrëdhënieve të punës në sektorin publik; mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në këtë sektor – duke e ndërthurur me të dhëna konkrete të procedurave dhe mënyrave të zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve; pasojat sociale dhe ekonomike që kanë aplikimi i secilës procedurë; dhe si ndikon secila zgjedhje (procedurë gjyqësore apo ndërmjetësim) në buxhetin e shtetit.

[Lexo më shumë >](#)

[Download](#)



Centre for Legal
Empowerment
www.cle.al



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

**NDËRMJETËSIMI,
SI ALTERNATIVË PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJEVE NË PUNË, ENDE
NJË “TABU” NË REALITETIN SHQIPTAR**

Dhjetor 2022

Autorë:

AV. MSC. ARBESA KURTI
AV. FRANC TERIHATI
PROF. DR. SOKOL MËNGJESI
AV. PIRRO BOBOLI

Marrëdhëniet e punës në industrinë e medias

Centre for Legal Empowerment në bashkëpunim me ekspertët Dr. Laura Çami (Vorpsi) dhe Dr. Av. Xhon Skëndëri, prezantuan për përfaqësues të mediave, gazetarë dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë studimin shkencor "Marrëdhëniet e punës në industrinë e medias".

Të drejtat midis punëdhënësit dhe punëmarrësit rregullohen qartazi në kontratën e punës që palët lidhin në sajë të bashkëpunimit dhe dakordësisë dypalëshe. Ekonomia e gjerë e tregut, shumëllojshmëria e formave dhe llojeve të biznesit ka treguar që ka gjithmonë hapësirë e nevojë për rregullimin apo përditësimin e kushteve dhe termave kontraktuale duke paraparë interesin e përbashkët të të gjitha palëve. Por sa të

adaptueshme janë këto forma për sektorë specifik sikundër është media? Ky studim vjen për ti dhënë përgjigje shumë prej pyetjeve dhe paqartësive mbi aspektet kontraktuale në industrinë e medias.



[Lexo më shumë >](#)

"Paraligjori në legjislacionin Shqiptar"?!

Sa e rëndësishme është përfshirja e paraligjorit në legjislacionin shqiptar në kuadër të rritjes së aksesit në shërbimet e ndihmës juridike për komunitetet vulnerabël?

Centre for Legal Empowerment ka ndërmarrë nismën për rregullimin e profesionit të paraligjorit në legjislacionin shqiptar, në kuadër të së cilës u zhvillua dhe tryeza e diskutimit me ekspertë, pedagogë, aktivistë dhe studentë, "Përfshirja e paraligjorit në legjislacionin shqiptar". Aktiviteti ishte i hapur për të gjithë të interesuarit të cilët patën mundësinë të mësonin më shumë rreth temës, por edhe të ndanin mendimet dhe opinionet e tyre me ekspertë të fushës. Në kuadër të kësaj nisme CLE, gjithashtu ka hartuar dhe propozuar draftin e një VKM-je për rregullimin e këtij profesioni.



[Lexo më shumë >](#)

Trajnimi fillestar për paraligjorët

CLE në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas zhvilluan ciklin e trajnimeve me temë: "Trajnim fillestar i paraligjorëve të angazhuar pranë Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore, OJF-ve si dhe komuniteteve të ndryshme".

Cikli i trajnimeve u zhvillua në platformën Zoom dhe u fokusua në 5 tema të ndryshme që kanë të bëjnë me ndihmën paraligjore. Ky cikël trajnimesh u pasua nga vizita në Qendrat Parësore të Ndhmës Juridike ku pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen nga afër me punën e këtyre qendrave. Këto aktivitete janë ndër nismat e para në vend për kualifikimin e individëve në profesionin e paraligjorit, një profesion ende i parregulluar në legjislacionin shqiptar.

[Lexo më shumë >](#)

Vepro@Mjedisi: Të rinjtë aktiv për një shoqëri Evropiane të gjelbër

CLE ka zbatuar projektin Vepro@Mjedisi, për të rritur aktivizmin rinor dhe informimin në lidhje me çështjet mjedisore në aspektin ligjor, në kuadër të programit Tirana European Youth Capital me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar dhe në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës,

Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar një sërë aktivitete në harkun kohor nga Maji në Dhjetor 2022.

Ndër hapat e parë të projektit ishte krijimi i 4 manualeve informues mbi temat:

- E drejta e komunitetit dhe OJF-ve për të adresuar në gjykatë çështjet e dëmtimit të mjedisit
- Raste nga praktika e dëmtimit të mjedisit si pasojë e ndërtimit të hidrocentraleve
- Ndryshimet Klimatike dhe Kuadri Ligjor
- Ilustrimi i praktikave pozitive të ekonomisë rrethore dhe të gjelbër



[Lexo më shumë >](#)

Në bazë të këtyre manualeve u zhvilluan dhe 4 trajnime me studentë të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës dhe Durrësit, të cilët patën mundësinë të diskutojnë dhe praktikojnë njohuritë e tyre mbi të drejtat mjedisore. Pas trajnimeve 5 nga këta studentë, u angazhuan në krijimin e një Manuali për të Drejtat Mjedisore të fokusuar në këndvështrimin e tyre mbi situatën mjedisore. Njëkohësisht në platformën juristionline.al u publikuan një sërë pyetjesh të shpeshta në lidhje me problemet mjedisore. Faza e fundit e këtij projekti do të jetë dhe publikimi i një video informuese mbi adresimin e çështjeve mjedisore në Gjykatë.

Zyra e Planifikimit të Karrierës

Zyrat e Karrierës është dhe nisma më e fundit e CLE e cili fokusohet në rëndësinë e këtyre zyrave në fakultete duke i dhënë përgjigje disa prej pyetjeve që shumë studentë kanë mbi këto struktura.

A janë këto zyra funksionale në fakultetet vendase? A ka struktura të tilla në fakultete? Sa të informuar janë studentët në lidhje me shërbimet që ato ofrojnë?

Të nisur nga këto pyetje, 3 studentë të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës u angazhuan pranë Centre for Legal Empowerment në kuadër të nisme të iniciuar në korrik.

Përmes një monitorimi të bërë në fakultetet e Universitetit të Tiranës është konstatuar mungesa e Zyrës së Karrierës në Fakultetin e Drejtësisë, dhe mungesa e informimit e studentëve mbi këto zyra në Fakultete të tjera ku këto struktura janë funksionale.

Në kuadër të këtij konstatimi u formua dhe plani i punës për monitorimin nga afër të modele të ndryshme të Zyrave të Karrierës për të formuluar një manual informues dhe këshillues me titull “Zyrat e Karrierës”. Manuali u prezantua para studentëve të FDUT dhe Dekanatit të Fakultetit të cilët shprehën dhe mbështetjen e tyre për punën.

Manuali “Zyrat e Karrierës” synon informimin mbi këto struktura dhe mirëfunksionimin e tyre në fakultetet vendase.



[Lexo më shumë >](#)



Western Balkans Roma Summit

Centre for Legal Empowerment, në vijimësi të punës së saj për fuqizimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit Rom në Shqipëri, ishte e ftuar në “Western Balkans Roma Summit” të organizuar nga Civil Rights Defenders, në datat 17 -18 Nëntor 2022, në Prishtinë, për të prezantuar dhe njohur pjesëmarrësit me angazhimin dhe punën e qendrës dedikuar sfidave të fuqizimit të komunitetit Rom në vendin tonë.

Drejtori Ekzekutiv i CLE, z. Franc Terihati, gjatë fjalës së tij paraqiti për të pranishmit në samit një pasqyrë të

plotë mbi punën konkrete të CLE në mbështetje të komunitetit Rom, nga fuqizimi ligjor, ndihma juridike dhe zgjidhja përfundimtare e disa betejave gjyqësore ku komuniteti ka rezultuar fitues dhe përfitues. Samiti mbledh përfaqësues të komunitetit Rom, shoqërisë civile dhe vendimmarrës nga i gjithë rajoni çdo vit, për të diskutuar mbi punën dhe aktivizmin social për gjithëpërfshirjen dhe barazinë e komunitetit Rom në shoqëritë tona.



[Lexo më shumë >](#)

WORLD JUSTICE FORUM

Centre for Legal Empowerment mori pjesë në World Justice Forum 2022 të zhvilluar në Hagë, Hollandë.




E ftuar në këtë aktivitet, CLE prezantoi nismën, punën dhe sukseset e saj si ndihma ligjore falas parësore dhe dytësore, çështjet e litigimit strategjik, ndihma juridike përmes platformës www.juristionline.al etj.

World Justice Forum organizohet çdo vit nga World Justice Project dhe synon të ndikojë në garantimin e të drejtës për më shumë siguri, liri dhe drejtësi për qytetarët.

[Lexo më shumë >](#)

Organizatrat më me emër të angazhuara në çështjet e drejtësisë u bashkuan në këtë forum për të diskutuar mbi zbatueshmërinë e ligjit, ndihmën ligjore, aksesin në drejtësi dhe shtetin e së drejtës.





Centre for Legal Empowerment

Newsletter



janar- dhjetor
2022

Juristi Online

Për të siguruar garantimin e ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore, Centre for Legal Empowerment - CLE ka ndërtuar platformën unike JURISTIONLINE. Juristi Online është pjesë e e-albania duke garantuar Ndhimë Ligjore Falas për çdo qytetar shqiptar 24 orë në 24 orë në 7 ditë të javës.

Gjatë periudhës **Janar - Dhjetor 2022**, në platformën Juristi Online, janë adresuar **1702 pyetje** nga qytetarët

520 çështje Civile (pronësia, trashëgimia, detyrime, kontrata; tituj ekzekutiv, përfaqësim, tregtare)

360 çështje Administrative (sigurime shoqërore, gjendja civile, taksa, gjoba; leje qëndrimi; shtetësia; aksesit në shërbime publike, NE)

291 çështje të Tjera (ndihmë juridike falas, lëvizje jashtë shtetit; të dhënat personale; legjislacion)

137 çështje Familjare (kujdestaria, pension ushqimor, zgjidhje martesë, njohje atësie)

128 çështje për Procedurat Gjyqësore (afatet procedurale; të provuarit; ankimet)

113 çështje mbi Marrëdhëniet e Punës (paga; zgjidhja e kontratës; pushimet e paguara)

103 çështje Penale (aksesi në prokurori; vepra penale; afatet dhe procedurat hetimore; rehabilitim)